

VENDIM
Nr.163, datë 21.3.2007

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.515, DATË 19.7.2006 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR RISTRUKTURIMIN E INSTITUTEVE KËRKIMORE-
SHKENCORE, NË VARËSI TË MINISTRISË SË BUJQËSISË, USHQIMIT DHE
MBROJTJES
SË KONSUMATORIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 12, 13 e 14 të ligjit nr.7893, datë 22.12.1994 “Për shkencën dhe zhvillimin teknologjik”, të ndryshuar, dhe të neneve 21, 27 e 29 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.515, datë 19.7.2006 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto shtesa:

1. Pas pikës 13/1 shtohen pikat 13/2 e 13/3, me këtë përmbajtje:

“13/2. Për arsye të karakterit sezonal të krijimit të të ardhurave në QTTB-të dhe në Stacionin e Duhanit, Cërrik, pagat e punonjësve me kontratë dhe shpenzimet operative, të domosdoshme për krijimin e të ardhurave të planifikuara, në gjashtëmujorin e parë të vitit, të përballohen nga Buxheti i Shtetit. Shuma e përdorur për këtë qëllim të rikthehet në Buxhetin e Shtetit, pas krijimit të të ardhurave, brenda vitit buxhetor.

13/3. Përgjashtimisht për vitin 2007, gjendja e llogarive likuiduese të ish-instituteve kërkimore-shkencore, të trajtohet si e ardhur jashtë limitit dhe të përdoret për shpenzime operative. Kjo shumë të rikthehet në Buxhetin e Shtetit pas krijimit të të ardhurave, brenda vitit buxhetor.”.

2. Pas pikës 14 shtohet pika 14/1, me këtë përmbajtje:

“14/1. Të ardhurat e krijuara nga ish-Instituti i Kërkimeve Veterinare, Tiranë (IKV) për periudhën 1995-2006, në shumën 96 000 000 (nëntëdhjetë e gjashtë milionë) lekë dhe të ngrira në llogari bankare, të investohen për përmirësimin e infrastrukturës laboratorike dhe për transferimin e Institutit të Kërkimeve të Ushqimit, Tiranë (IKU) në mjediset e Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, Tiranë (ISUV).”.

3. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha